

Fjala e mbylljes së punimeve të Konferencës nga akademik Rexhep Ismajli

Znj. Nënkryetare e ASHAK-ut, akademik Justina Shiroka-Pula,

Kolegë dhe pjesëmarrës të nderuar,

Konferencës sonë frymëgjatë i erdhi fundi. Për dy ditë patëm një veprimtari jashtëzakonisht të ngjeshur me raporte, shqyrtime e diskutime të menduara dhe të thelluara për çështje nga më të ndryshmet që lidhen me studimet, udhëpërshkrimet dhe shkrimet për gjuhën, për letërsinë, për historinë, për etnologjinë dhe për arkeologjinë e për botën shqiptare në përgjithësi në Britaninë e Madhe dhe në vendet e Europës Veriore. Falë dhe vetë gjerësisë së atyre shkrimeve e studimeve këtë here na doli e nevojshme dhe shumë e dobishme që vështrimet tona të mos jenë të përqendruara vetëm në aspektet filologjike, pot ë zgjerohen dyfish: me paraqitje edhe raportimesh për studimet historike, për vështrimet e kumtimet arkeologjike, ashtu si për vrojtimit udhëpërshkruese, e deri te komentimet politike-shoqërore. U bë një hap me rëndësi drejt trajtimeve multidisiplinare, çka po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme në studimet tona. E vlerësojmë angazhimin e studuesve albanologë në këto diskutime, ashtu siç e vlerësojmë angazhimin e studuesve në fushat e anglistikës e të degëve të tjera filologjike, të historisë dhe të arkeologjisë, të etnologjisë dhe të studuesve të tjerë.

Në seanca të ndryshme të punimeve tona u diskutua posaçërisht për personalitetet e mëdha të botës albanologjike britanike: Stuart Mann, Edith Durham, Noel Malcolm, ashtu si për studues skandinavë, si Holger Pederesen, Gunna Svane apo Kristian Sandfeld. U lexuan gjithsejtë 40 kumtesa me spektër të ndryshëm problematizimesh.

Tash Këshilli Organizativ mendon se autorëve të kumtesave t'u jepet një kohë. Ata që i kanë përfundimisht të gatshme mund t'i dorëzojnë menjëherë, ndërsa ata që mund të kenë nevojë edhe për ndonjë rishikim, jepet një kohë që deri më 15 shkurt ta dorëzojnë versionin përfundimtar. Burimi i akteve duhet të dale gjatë gjysmës së vitit 2024.

I falënderoj ngrohtësisht të gjithë pjesëmarrësit në Konferencë nga viset e ndryshme të botës, nga vendet ballkanike, nga Shqipëria, nga Kosova, për ndihmesat e tyre për suksesin e konferencës. E falënderoj akademik Gëzim Hoxhën për bashkëpunimin lidhur me organizimin dhe për ndihmesën lidhur me begatimin e përmbajtjes së konferencës me ndihmesat arkeologjike, çka u prit mirë nga Këshilli Organizues dhe besoj edhe nga të gjithë pjesëmarrësit e Konferencës.

Kemi bërë përpjekje për t'i pasur midis nesh të gjithë të interesuarit potencialë, sidomos nga Britania e Madhe, por, si duket, kanë ndërhyrë agjenda të ndryshme. Kur e nisëm serinë e Konferencave na dukej fundi i tetorit më i përshtatshëm. Kështu shkoi me të parat. Por tash patëm dhe një varg të ngjashmesh, edhe në Prishtinë dy konferenca për përvjetorin e Konferencës së Londrës. Për të tilla aspekte duhet të mendojmë në të ardhmen.

Sido që të jetë, mendoj se realizuam një konferencë shumë të suksesshme, me shumë prurje dhe rezultate nga laboratorit hulumtues dhe me këtë e plotësuam hartën e studimeve për shqiptarët në një pjesë të madhe të botës perëndimore në këtë prerje. Na mbetet të mendojmë për një mundësi të përshtatshme për të parë këto aspekte vrojtimi në raport me Turqinë dhe botën osmane e arabe, në botën sllave, e posaçërisht me vendet ballkanike përreth, sidomos me hapësirat e ish-Jugosllavisë, të Bullgarisë, të Greqisë dhe të Rumanisë.

Falënderoj të gjithë ju që morët pjesë aktive dhe ata që na dëgjuan. Falënderoj posaçërisht pjesëmarrësit nga vendet e tjera, që nga SHBA e deri te vendet e ndryshme europiane, si Gjermania, Italia, etj. Gëzohemi posaçërisht për praninë e një brezi të rinjsh që po vjen në albanologji.

Mirupafshim në takimin e ardhshëm.